



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:155025
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05487217

Ac.nr.2640/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari individual Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit NH “I.L” Sh.A me seli në Prishtinë, kundër debitorit M.I nga fshati D., Komuna Vushtrri, me objekt përmbartimi kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë–Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CPP.nr.58/21, të datës 28.01.2022, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit NH “I.P” Sh.A me seli në Prishtinë, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, CPP.nr.58/21 i datës 28.01.2022, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin e ankimuar CPP.nr.58/21 të datës 28.01.2022, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit M.I nga fshati D., Komuna Vushtrri, dhe ka shfuqizuar pjesërisht Urdhrin për Lejimin e Përmbartimit të Përmbartuesit Privat P.nr.07/21, datë 12.01.2021 për periudhën kohore 2018 dhe 2019, dhe ka detyruar debitorin M.I, që në emër të borxhit të papaguar për shfrytëzimin e ujit për ujitje, kreditorit N.H “I.L” Sh.A, t’ia paguajë shumën totale prej 91.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e ushtrimit të propozimit 11.01.2021, e gjer në përmbushjen përfundimtare të detyrimit.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi ose rasti të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori duke i propozuar gjykatës që ankesa e debitorit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, ka gjetur se:

Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se kreditori, me datë 11.01.2021 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri ka ushtruar propozim për përmbartim sipas dokumentit të besueshëm – faturave 81 dhe 82, kundër debitorit M.I nga fshati D., Komuna Vushtrri, duke kërkuar përmbartjen e detyrimit nga debitori dhe atë në emër shfrytëzimit të ujit për ujitje, në shumë prej 481.00 euro, me kamatë 8% si dhe shpenzimet e procedurës.

Përmbartuesi Privat me Urdhrin për Lejimin e Përmbartimit P.nr. 07/21 të datës 12.01.2021, ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi propozimin për përmbartim me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet për përmbartim, e ka kundërshtuar lartësinë e borxhit dhe ka deklaruar se borxhi është i parashkruar konform nenit 360 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, po ashtu ka theksuar se i njëjti ka bërë pagesa në emër të kontratës dhe faturës, dhe se lartësia e këtij borxhi nuk është reale porse është më e vogël, prandaj mbi bazën e të gjitha këtyre arsyeve ka kërkuar nga gjykata që ta refuzoi propozimin për përmbartim dhe anuloi urdhrin për lejimin e përmbartimit.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim, me propozimin që të refuzohet prapësimi i debitorit ndërsa urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimit, me aktvendimin CPP.nr.58/21 i datës 28.01.2022, ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, duke vendosur më saktësisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimit.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimit, tani për tani, nuk e përkrah Gjykata e Apelit e Kosovës, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktvendimi i ankimit është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale për të cilën gjykata e shkallës së dytë çdo herë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK dhe e cila shkelje sipas vlerësimit të kësaj gjykate ka ardhur si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, dispozitivi i

aktvendimit të ankimuar, është kontradiktor dhe në kundërshtim me arsyet mbi faktet vendimtare në të cilat është thirrur gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar CPP.nr.58/21 i datës 28.01.2022, është kontradiktor dhe në kundërshtim me arsyet mbi faktet vendimtare, për faktin se gjykata e shkallës së parë në njërën anë e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e shfuqizuar pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr. 07/21 të datës 12.01.2021, për periudhën kohore 2018 dhe 2019, pa specifikuar se cila është shuma për të cilën shfuqizohet urdhri përmbarimor, ndërsa në anën tjetër e ka detyruar debitorit që në emër të borxhit të pa paguar për shfrytëzimin e ujit për ujitje, kreditorit ti paguaj shumën prej 91.00 euro. Në lidhje me këtë, qëndron pretendimi ankimor i kreditorit se dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyetimin pasi që në dispozitiv të aktvendimit gjykata e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, ndërsa në arsyetim në faqen e parë, paragrafi i fundit gjykata arsyeton se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, që nuk është e rregullt një vendosje e tillë e gjykatës së shkallës së parë, ku në të njëjtën pikë të dispozitivit pjesërisht e aprovon prapësimin e debitorit, nuk sqaron se cila është shuma e cila shfuqizohet e në anën tjetër në arsyetim shton se prapësimi i debitorit është i pa bazuar. Kjo përbën bazë të mjaftueshme procedurale për të anuluar një dispozitiv të tillë nga gjykata e shkallës së dytë, për shkak të paqartësisë dhe dykuptimësisë së tij.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të ankimuar, Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, edhe për shkak se qëndrojnë pretendimet e palës kreditore se gjykata gabimisht ka trajtuar kartelën e konsumatorit me ç'rast, aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5, të Ligjit të Procedurës Kontestimore, si dhe lidhur me nenin 4, 17, 29 dhe 73 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur dispozitave të cituara për arsyetimin e aktvendimit sepse nuk ka paraqitur në mënyrë të strukturuar dhe të kuptueshme cilat kanë qenë kërkesat e palëve respektivisht kundërshtimet, cilat kanë qenë faktet vendimtare, cilat prova janë shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe si janë vlerësuar ato dhe si pasojë ka dështuar të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Me nenin 29 paragraf 1, pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokument i besueshëm sipas këtij ligji, janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Ndërsa me paragrafin 1 pika 1.3 përcaktohet se: *“Dokument i besueshëm sipas këtij ligji, është fatura”*. Në këtë rast në shkresat e lëndës si prova materiale gjendet kartela e konsumatorit për periudhën 2000-2020, e datës 06.01.2021, ndërsa nga raporti i llogarisë për konsumatorin llogaritet qarkullimi për periudhën raportuese nga data 11.06.2010 deri me datë 01.01.2021.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të fakteve të çështjes, ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat ligjore të LPP-së dhe LMD-së për arsye se në këtë rast gjykata e shkallës së parë, nuk ka arsyetuar faktet vendimtare sa i përket periudhës kohore, përkatësisht se për cilën periudhë kohore kërkohet përmbushja e detyrimit nga ana e debitorit, sa ka qenë ajo shumë, a ka paguar debitori borxhin për atë periudhë kohore, a e ka pranuar borxhin kreditori, dhe a ka pasur marrëveshje për programim të borxhit

ndërmjet kreditorit dhe debitorit, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Po ashtu sa i përket parashkrimit gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me institutin e parashkrimit, në të cilin është thirrur debitori me anë të prapësimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk ka pengesa që lidhur më evitimin e paqartësive në këtë lëndë përmbare, në kuptim të nenit 73 par. 1 të LPP-së, gjykata e shkallës së parë eventualisht të caktoj seancë publike në të cilën do të ftoj palët në procedurë dhe pastaj përmes dëgjimit dhe deklarimit të tyre, por edhe përmes pyetjeve të cilat do të mund tu parashtraheshin nga gjykata, ajo do të kishte mundësi objektive dhe reale që t'i eliminonte paqartësitë, duke mos përjashtuar edhe hetimin e ndonjë rrethane tjetër e cila do të ishte në interes të gjykatës për të vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe të merrte një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, pa përjashtuar edhe aspektin e udhëzimit të palës përkatëse në kuptim të veprimeve procedurale të cilat ajo palë mund apo duhet t'i kryej për sqarimin dhe plotësimin e dokumentit përkatës përmbare në mënyrë që procedura në këtë çështje përmbare të përfundoj me nxjerrjen e një vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbi bazën e shkeljeve të konstatuara si më lartë, kjo gjykatë gjeti se aktvendimi i ankimuar duhet prishur dhe çështja duhet kthyer në rivendosje tek gjykata e shkallës së parë, pasi që në rastin konkret nuk ka pasur kushte që i njëjti aktvendim të mund të ndryshohej nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që t'i evitoj paqartësitë e evidentuara në dispozitiv të aktvendimit të cekura si më lartë, pastaj të trajtoj të gjitha pretendimet e kreditorit dhe debitorit në lidhje me çështjet e ngritura në këtë procedurë përmbare dhe sqaroj të gjitha paqartësitë lidhur me ekzekutimin e urdhrin përmbare, pastaj gjykata të vlerësojë përshtatshmërinë e dokumentit të besueshëm në kuptim të dispozitës 29 të LPP-së, në mënyrë që e njëjta pastaj duke aplikuar drejtë normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të bie një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitivin e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbare *"në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual"*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (d) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PPISHTINË
Ac.nr.2640/2022, datë 21.03.2024

G j y q t a r i,
Ylber Shurdhiqi